

2020

BEI NË NJË "VËSHTRIM



European
Investment
Bank Group

Nga energjia e pastër në Estoni te uji i pijshëm në Lesoto ose një spital më i mirë në Kroaci, Banka Evropiane e Investimeve përmirëson miliona jetë çdo vit.

Si banka e Evropës për klimën, ne po e ndihmojmë botën të përmbushë Marrëveshjen e Parisit dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ne zotohemi të krijojmë 1 trilion euro në investime për klimën gjatë dekadës së ardhshme.

Që nga viti 1958, ne kemi ofruar kredi dhe këshilla ekspertësh për mijëra projekte në mbi 160 vende. Ne investojmë në të ardhmen e Evropës duke punuar paralelisht me Komisionin Evropian dhe shumë institucione të tjera.

Ne, si huadhënësi më i madh shumëpalësh dhe miqësor me mjedisin, ndihmojmë në lulëzimin e ekonomive, krijimin e vendeve të punës dhe promovimin e barazisë. Ne e masim punën tonë me dobinë që sjell në shoqëri sepse pas çdo investimi qëndron një jetë më e mirë.



Në Rijeka të Kroacisë, Spitali i ri për Nënat dhe Fëmijët po lehtëson jetën e 600,000 njerëzve. Ai mbështetet nga një kredi e dhënë nga BEI-ja, e shoqëruar me mbështetje këshilluese nga BEI-ja dhe Komisioni Evropian.

Ndikimi ynë në 2019

280 miliardë euro	investime të mbështetura nga aktivitetet e BEI-së
72,2 miliardë	financime të Grupit të BEI-së
1 095	projekte të nënshkuara
50,3 miliardë euro	për tregjet e obligacioneve
Mbi 25 miliardë euro	financime për bizneset e vogla
Mbi 19 miliardë euro	për masa mbi klimën
Mbi 16 miliardë euro	për mbrojtjen e mjedisit
Mbi 14 miliardë euro	për nxitjen e inovacionit
4,4 milionë	vende pune të ruajtura në bizneset e vogla
10 milionë	njerëz pijnë ujë më të sigurt
12 milionë	njerëz marrin shërbim më të mirë shëndetësor
7,4 milionë	shtëpi të lidhura me energji elektrike
117 milionë	njerëz përfitojnë lidhje më të mira celulare
631 milionë	udhëtime shtesë me transport publik
1,7 milionë	njerëz përballen me rreziqe të reduktuara përmbytjeje
5,1 milionë	m ² sipërfaqe ndërtimi me energji efikase



Projektet e mbështetura nga BEI-ja në vitin 2019 do të prodhojnë 13.177 MW energji, e mjaftueshme për të furnizuar 7,4 milionë shtëpi.

Klima

Klima është sfida më e madhe e brezit tonë. Ajo do të përcaktojë mirëqenien dhe jetëgjatësinë e fëmijëve tanë. Qëllimet tona klimatike dhe energjetike po vendosin standarde të reja në Evropë dhe më gjerë. Në të ardhmen e afërt, ne do të ndalojmë mbështetjen e karburanteve fosile dhe do të kushtojmë 50% të investimeve tona masave për klimën dhe qëndrueshmërinë.

Ne ndihmojmë në trajtimin e efekteve të ndryshimit të klimës në komunitetet e cënueshme, mbrojtjen e biodiversitetit dhe promovimin e bujqësisë së qëndrueshme. Ne ruajmë gjithashtu burimet natyrore dhe po e bëjmë mjedisin një vend më të sigurt për brezat e ardhshëm. Ne mendojmë për klimën në gjithçka që bëjmë. Çdo projekt që ne mbështesim lidhur me inovacionin, bizneset e vogla ose infrastrukturën duhet të përmbushë qëllimet tona klimatike.



Me mbështetjen e BEI-së, kompania estoneze "Elcogen" po furnizon tregun masiv me energji elektrike efikase dhe të pastër bazuar në karburant.

Inovacioni

Inovacioni e mban Evropën konkurruese dhe krijon vende pune me vlera të larta. Grupi i BEI-së i mundëson kompanive evropiane të krijojnë teknologjinë më të fundit. Ne i kthejmë idetë inovative në suksese biznesi.

Banka mbështet kërkime dhe zhvillim në shkallë të gjerë, si dhe firma të vogla të specializuara. Investimet tona në sektorë të tillë si telekomunikacioni, aviacioni, mjekësia dhe digjitalizimi janë një vulë miratimi që tërheq fonde shtesë nga sektori privat.

Ne mbështesim shumë faza të inovacionit. Falë huave të Bankës, universitetet mund të ndërtojnë dhe shtrijnë objektet e tyre të kërkimit dhe kompanitë e reja mund të rrisin stafin dhe të përmirësojnë pajisjet e tyre. Ne ushqejmë idetë në mendjen e njerëzve që e bëjnë botën një vend më të mirë për të jetuar.



Në Itali, projekti kërkimor midis BEI-së dhe Unicredit mbështet disa qindra biznese inovatore të drejtuara nga gratë.

Përfshirja

Banka ofron një gamë të gjerë produktesh financiare me kushte të favorshme. Ne i japim hua sektorit publik dhe privat. Ne fuqizojmë bizneset e vogla dhe të rinjtë. Ne mbështesim gratë sipërmarrëse duke u dhënë atyre qasje në kredi dhe pozicione drejtuese. Ne bëjmë të mundur që shtresat e popullsisë me të ardhura të ulëta, të vetëpunësuarit dhe mikro-ndërmarrjet të marrin financime dhe këshilla biznesi. Ne sigurohemi që askush të mos mbetet pas.

BEI-ja nuk jep hua më shumë se gjysmën e koston së një projekti. Në këtë mënyrë, ne veprojmë si një katalizator për të përfshirë më shumë sektorin privat, duke rritur nivelin e investimeve për projekte. Ne gjithashtu ofrojmë asistencë teknike për të siguruar që projekti të ketë sukses.



Projekti i zhvillimit i BEI-së në Lesotho të Afrikës do të sjellë ujë të pastër dhe të pijshëm dhe kanalizime për 300.000 njerëz në shumë pjesë të ultësirave.

Qëndrueshmëria

BEI-ja mbledh para duke lëshuar obligacione në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Vlerësimi ynë i shkëlqyer i kredisë na lejon të mbledhim fonde me interesa të mira. Ne ua kalojmë këto përfitime klientëve.

Ekspertët tanë të tregut të kapitalit kanë krijuar dhe zhvilluar tregun e gjelbër dhe të qëndrueshëm të obligacioneve. Ne jemi tashmë emetuesi më i madh mbikombëtar i obligacioneve të gjelbërta. Këto obligacione mbështesin energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, ujin e pastër dhe kanalizimet. Ne kemi arritur që financimi i qëndrueshëm të funksionojë.

Angazhimi

Ne jemi transparent dhe të përgjegjshëm për të gjitha aktivitetet tona. Standardet tona të larta mjedisore dhe sociale na bëjnë një partner të shkëlqyeshëm. Ne kemi një staf shumë të kualifikuar, të përkushtuar dhe të shumëllojshëm ekonomistësh, inxhinierësh, analistësh financiarësh dhe specialistësh të klimës që punojnë çdo ditë me ekspertë vendas, institucione dhe qeveri në të gjithë globin.

Për më shumë informacion mbi ofertat tona,
vizitoni www.eib.org/products.

Banka Evropiane e Investimeve

 info@eib.org
www.eib.org

Grupi i BEI-së përbëhet nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI) dhe Fondi Evropian i Investimeve (FEI).

BEI-ja është banka e Bashkimit Evropian. Ajo është huamarrësi dhe huadhënësi shumëpalësh më i madh në botë. Me seli në Luksemburg, BEI-ja ka një rrjet të madh të zyrevevendore dhe rajonale në Evropë dhe më gjerë.

FEI-ja mbështet bizneset e vogla duke përmirësuar qasjen e tyre në financa në Evropë dhe në një numër vendesh jashtë Evropës. FEI-ja harton dhe zhvillon sipërmarrjen dhe rritjen e kapitalit, garanci dhe instrumente mikro-financimi për të promovuar inovacionin dhe punësimin.

© Banka Evropiane e Investimeve, 2020

Foto: GettyImages, Shutterstock

Printuar në Condat Silk FSC Mix.

BEI-ja përdor letër të certifikuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes së Pyjeve (FSC). Sepse është bërë nga njerëz që i duan pemët.

Printuar nga Imprimerie Centrale

